Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të

lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë

operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen

kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbylljen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i kontratës: ***“Shërbim i pastrimit të ambienteve të jashtme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza, Tiranë”***

QSU “Nënë Tereza” Tiranë, është institucion kryesor shëndetësor i nivelit terciar, diagnostikues e trajtues për qytetarin, i cili shërben për formimin e stafeve mjekësore, si dhe shërben si një qendër referimi dhe mjekimi për vendin dhe rajonin. Shërbimi i pastrimit të territorit të jashtëm të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” është tejet i rëndësishëm, për të siguruar një ambient të pastër e cilësor për pacientët, personelin dhe gjithë vizitorët e shumtë, dhe përfshin :

1. Pastrimin e segmentit rrugorë (rrugë, sheshe, trotuare) + prerje barishtesh;
2. Larjen e segmentit rrugorë (rrugë, sheshe, trotuare);
3. Shërbimin e evadimit të mbetjeve urbane QSUNT –Landfill (2-4 herë sipas kërkesës së A.K-së).

Më poshtë sqarojmë secilin zë:

1. Pastrimi i segmentit rrugorë përbën një element thelbësor të funksionimit të pandërprerë dhe të sigurt të institucionit, duke qënë se QSUNT-ja ka fluks të vazhdueshëm pacientësh , shoqëruesish, staf mjekësor, etj, dhe mjete emergjence gjatë gjithë vitit, territori i jashtëm është i ekspozuar ndaj ndotjes së vazhdueshme urbane, kushteve atmosferike dhe të fluksit të lartë të lëvizjes së automjeteve. Në mungesë të pastrimit të rregullt, ambjentet e jashtme të territorit të QSUNT-së, kthehen në burim rreziku higjeno-sanitar, duke favorizuar grumbullimin e mbetjeve urbane, rritjen e ngarkesës mikrobiale dhe krijimin e kushteve të papërshtatshme për shëndetin publik. Ky shërbim kontribuon gjithashtu në garantimin e sigurisë fizike, duke parandaluar rreziqe si rrëshkitje, bllokim të aksesit dhe pengim të lëvizjes së autoambulancave dhe shërbimeve emergjente. Ky shërbim përfshin largimin e pluhurit, gjetheve në pjesë rruge, mbeturinave apo papastërtive, pastrimin e koshave për qark territorit, prerjen e barishteve dhe cdo pastrim që është i nevojshëm të kryhet në segmentin rrugor. Prerja e barishteve në segmentin rrugorë (rrugë, sheshe, trotuare) sistematikisht është i rëndësishëm së veçantë në vijueshmërinë e mirëmbajtjes dhe pastrimit të segmentit rrugorë dhe për shkak të karakterit të pandërprerë të aktivitetit të QSUNT-së e cila funksionin 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, gjatë gjithë vitit. Gjithashtu mirëmbajtja ditore është e domosdoshme për:

- Ruatjen e vazhdueshme të sigurisë së qarkullimit rrugor dhe këmbësor;
- Parandalimin e pengesave vizuale në hyrje –dalje, kthesa dhe kryqëzime;
- Garantimin e aksesit të pandërprerë të shërbimeve emergjente;
- Shmangien e krijimit të vatrave të rrezikut biologjik nga barishtet grumbulluara.

Për këto arsye, realizimi sistematik dhe i përditshëm i këtij shërbimi përbën një nevojë reale operacionale e diktuar nga funksioni, volumi dhe rëndësia e QSUNT-së, për garantimin e sigurisë, higjenes dhe vazhdimësisë së shërbimit shëndetësor publik.

2. Larja e segmentit rrugorë është proces i rëndësishëm vecanërisht në periudha me ndotje apo thatësi, për të ulur pluhurin. Ky shërbim përfshin pastrimin me ujë dhe kur është e nevojshme

me solucione pastruese, të rrugëve, trotuareve, shesheve dhe sipërfaqeve të jashtme në territorin e spitalit i cili do të bëhet sipas grafikut mujor që do ti jepet OE nga ana e AK. Segmentet rrugore brenda territorit të QSUNT-së janë të ekspozuara ndaj ndotjes jo vetëm nga pluhuri, por dhe baltërat, mbetje organike, lëngje të derdhura dhe ndotjet e tjera urbane që nuk mund te eliminohen vetëm përmes pastrimit të thatë. Larja me autobus uji siguron pastrim të thelluar të sipërfaqeve rrugore, duke reduktuar ndjeshëm ngarkesën mikrobiale dhe përmirësuar kushtet higjeno-sanitare në një mjedis ku trajtohen pacientë me imunitet të komprometuar.

- Shërbimi i evadimit të mbetjeve urbane përfshin largimin dhe transportimin e mbetjeve urbane nga ambientet e jashtme të spitalit drejt pikës përfundimtare të depozitimit të tyre (landfill). Nisur nga numri i lartë i pacientëve që marrin trajtim pranë QSUNT, realizimi i këtij zëri është mjaft i rëndësishëm pasi akumulimi i këtyre mbetjeve do te përbente burim për vatra infeksionesh dhe ndikim më gjerë në mjedis.

Duke qenë se Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka pësuar ndryshime në infrastrukturë, për të bërë një studim sa më të saktë dhe real për procedurën e prokurimit me objekt : *“Shërbim i pastrimit të ambienteve të jashtme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Brenda kufirit të QSUT janë hequr pasuritë (ndërtesat) të cilat nuk janë në përdorim nga QSUT dhe sipërfaqja e pasurive kaluar Fondit Shqiptar të Zhvillimit me anë të vkm nr.478 datë 24.07.2024.*

Gjithashtu ju informojmë se oborri i jashtëm i Pediatriisë së Specialiteteve gjatë kësaj kohe ka qenë në rikonstruksion dhe nuk është i azhornuar në planin e përgjithshëm të pronave të QSUT. Në këtë mënyrë azhornimi i tij në planin e përgjithshëm të pronave është përshtatur në autocad.

*Për sa më sipër, nga matjet në autocad të Azhornimit total të pronave të QSUT, **sipërfaqja e rrugë, shesheve dhe trotuareve rezulton rreth 69 471.275 m2.** Bashkëngjitur do të gjeni azhornimin total të kufirit të pronave në përdorim nga QSUNT”.*

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Sasia/ ditë	Frekuenca totale/ dite për 24 muaj
1	Pastrim i segmentit rrugorë (rrugë, sheshe, trotuare) + prerje barishtesh	m2	69,471	730
2	Larje e segmentit rrugorë (rrugë, sheshe, trotuare)	m2	69,471	190

3	Shërbim evadimi të mbetjeve urbane QSUNT -Landfill (2-4 herë sipas kërkesës së A.K.-së)	kg	deri 2520	730
---	---	----	-----------	-----

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1. Grafiku i zbatimit të shërbimit për cdo muaj, pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor, i dorëzohet operatorit ekonomik, për zbatim.
2. Subjekti menjëherë me lidhjen e kontratës, kur të fillojë ofrimin e shërbimit, duhet të dorëzojë sa herë kryen dorëzimin e mbetjeve në landfill (kusht i domosdoshëm) dokumentin e dorëzimit të mbetjeve me sasi të e derdhura (raportin faktit për sasi të e depozituara).
3. Operatori Ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të licensuar për depozitimin e mbetjeve urbane.
4. Personeli i OE është përgjegjës për njohjen dhe zbatimin e rregulltave të pastrimit në QSUNT si dhe është i detyrues të :
 - Të zbatojë në punë orarin e caktuar
 - Të ketë etik dhe komunikim gjatë procesit të punës
 - Të jenë bashkëpunues në rastet e nevojshme dhe të vecanta për ofrimin ekstra të këtij shërbimi
 - Të zbatojë me përpikmëri zërat e preventivit sipas planit mujor të miratuar.
 - Të jenë të veshur me veshje përkatëse identifikuese të pajisur me doreza, me karta identifikuese të personelit të cilat mbulohen nga Operatori Ekonomik, si dhe do të zbatojnë rregullat e brendshme, të vendosura nga QSUNT-ja.

OE duhet të ketë numrin e punëtorëve dhe përgjegjësit e tyre sipas kontratës dhe do ti vihet në dispozicion AK menjëherë me lidhjen e kontratës. Gjithashtu krahas numrit të punonjësve duhet të paraqesë:

Listën e makinerive dhe mjeteve të punës sipas kontratës dhe specifikimeve në kontratë.

Personin e autorizuar për ndjekjen e kësaj kontrate në QSU “Nënë Tereza” (këto dokumenta do të vijnë zyrtarisht të protokolluara)

5. Për shërbimin e evadimit të mbetjeve urbane:
 - peshore e përshtatshme në mënyrë që të bëhet peshimi i mbetjeve në çastin e dorëzimit, sa herë kryhet evadimi i mbetjeve urbane, që të bëhet rakordimi i peshës mbetje/për tërheqje. Peshoret duhet të jenë të kolauduara dhe çertifikuara nga DPM.
 - Shërbimi i evadimit të mbetjeve urbane do të kryhet 2-4 herë në ditë, kryesisht herët në mëngjes, në fund të ditës dhe sa herë është e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor.
 - Pastrim të zonës pas çdo tërheqjeje.

Sasia e mbetjeve në kg janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë AK për të blerë shërbimin për ti larguar ato. Ak ka të drejtë të marrë më pak ose më shumë shërbim për evadimin e tyre brenda sasisë së parashikuar në preventiv (**deri 2520 kg në ditë**). Pra në varësi të mbetjeve urbane që QSUNT gjeneron në ditë, apo cdo proces evadimi, likuidimi do të bëhet në bazë të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme (urbane që është kush i domosdoshëm për ti mbajtur që mund të shoqërohet edhe me dokumente të tjera shoqëruese si fatura dhe/ose mandate ose dokumenta të tjera provuese të lëshuara në landfill). Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompesimi dhe nuk do ti lejohet të bëjë ndryshime të cmimeve të njësisë përgjatë afatit të mbulimit të marrëveshjes kuadër, për 24 muaj nga data e lidhjes.

6. Për pastrimin e segmentit rrugor dhe prerje e barishteve:

Operatori Ekonomik duhet të ketë për pastrimin e territorit të jashtëm materiale pastrimi si fshesë dore profesionale, thasë plastikë, gërshërë prerese barishtesh, karrocë transporti, lopatë si dhe shishe me solucion dezinfektuese për zona me ndotje organike.

Për pastrimin është e rëndësishme ndarja e këtij territori në zonat e caktuara nga Autoriteti Kontraktor, në mënyrë që mbulimi i pastrimit të territorit të bëhet në mënyrë sa më efikase dhe sa më mirë.

Punëtorët e turnit të parë duhet të merren me zbrasjen dhe pastrimin e koshave me rrotullim, pastrimin e hyrjeve kryesore si dhe sheshet e godinave spitalore sipas zonave përkatëse dhe më tej me pastrimin e segmenteve rrugore, trotuareve dhe hapësirat e parkimit.

Punëtorët e turnit të dytë, pëveç detyrave sa më sipër cituar për punonjësit e turnit të parë, duke marrë parasysh faktin që gjatë mbasdites fluksi i automjeteve bie dhe parkimet pothuajse janë të lira, primar duhet të kenë në fokus pastrimin e zonave të parkimit.

Ndarja e zonave :

Zona e parë përfshin Hyrjen Kryesore të QSUT, territorin e Spitalit Onkologjik, territorin e Akseleratorit Onkologjik, territorin e Godinës së Spitalit Infektiv , territorin e Godinës së Konsultave , si dhe parkimet e QSUT në këtë zonë;

Zona e dytë, përfshin territorin e Spitalit e Djegie Plastikës, territorin e Spitalin Ditor nga para, territorin para dhe mbrapa Godinës së 6 katëshit, territorin e Kaldajës deri në hyrje të Mjeksisë Ligjore si dhe parkimet e QSUT-së përreth këtyre zonave;

Zona e tretë, përfshin territorin e Spitalit Qendror (duke përfshirë dhe pjesën midis Godinës A1 dhe A2, hyrjen në -1 nga mbrapa të familjarëve, hapësirën midis Godinës Qendrore dhe Drejtorisë deri tek Kardiokirurgjia), territorin e Drejtorisë së QSUNT-së para dhe pas, si dhe parkimet e QSUT në këtë zonë.

Zona e katërt, përfshin territorin përpara dhe pas Spitalit të Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjisë Vazale, territorin përreth Spitalit Francez (duke përfshirë dhe segmentin rrugor hyrjen e automjeteve nga trau, në krah të Drejtorisë deri tek Fakulteti Stomatologjia), territorin e Depos së Farmacisë Qendrore, si dhe parkimet e QSUT-së përreth këtyre zonave;

Zona e pestë, përfshin territorin e Godinës së Statistikës (ish-rektorati), territorin e të gjithë Godinave të Pediatrisë, zona midis Stomatologjisë , Fakultetit të Infermierisë , Fakultetit Teknik Mjekësor dhe përreth tyre dhe parkimet e QSUT-së përreth tyre;

Zona e gjashtë përfshin Spitalin Nr.5 (Neurologjinë, Neurokirurgjinë, Shërbimin e Psikiatrisë) dhe parkimet përreth territorit të tyre;

Duhet të merren parasysh nga ana e O.E., oraret e pastrimit dhe ndarjes së turneve, si më poshtë përgjatë sezoneve.

1. Sezoni Pranverë-Verë

Fillon nga ora 06:00 deri në orën 21:00

Turni i paradites : 06:00-14:00 (gjysmë ore pushim për punëtorët për t'u çlodhur)

Turni i pasdites: 14:00-21:00

2. Sezoni Vjeshtë-Dimër

Fillon nga ora 07:00 deri në orën 21:00 (mund të ndryshohet me kërkesë të AK)

Turni i paradites: 07:00-15:00 (gjysmë ore pushim për punëtorët për t'u çlodhur)

Turni i pasdites: 15:00-21:00

Gjatë orarit të pushimit territori nuk duhet të ngelet i pambuluar me punëtor si dhe orari mund të ndryshohet me kërkesë të Autoritetit Kontraktor. Cdo zonë pastrimi duhet të mbulohet me nga një punonjës.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“Shërbim i pastrimit të ambienteve të jashtme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza, Tiranë”.**

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Sasia/ ditë	Frekuenca totale/ dite për 24 muaj
1	Pastrim i segmentit rrugorë (rrugë, sheshe, trotuare) + prerje barishtesh	m2	69,471	730
2	Larje e segmentit rrugorë (rrugë, sheshe, trotuare)	m2	69,471	190
3	Shërbim evadimi të mbetjeve urbane QSUNT - Landfill (2-4 herë sipas kërkesës së A.K.-së)	kg	2520	730

Afati i ekzekutimit të shërbimit është: 24 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: ***“Shërbim i pastrimit të ambienteve të jashtme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza, Tiranë”.***

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: QSUT

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. *Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024) të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë shërbimi / apo çdo dokument tjetër me një landfill për depozitimin e mbetjeve për periudhën e zbatimit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme, e cila përfshin objektin e prokurimit), si më poshtë si më poshtë:

- SSH EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 45001 “Sisteme të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

2.3.6 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit objekt prokurimi për territorin e QSUT, duhet të kenë të punësuar minimumi 21 punonjës, si më poshtë:

- 2 punonjës Përgjegjës shërbimi / per 2 turne
- 3 punonjës shofer
- 6 punonjës shërbimi turni i parë
- 6 punonjës shërbimi turni i dytë
- 2 punonjës ndihmës për evadimin e mbetjeve turni i parë
- 2 punonjës ndihmës për evadimin e mbetjeve turni dytë

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a. Për Përgjegjësin e Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi /Ekspert Mjedisi dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi / Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

b. Për punonjësit e shërbimit/ pastrimi

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

-
- c. Për punonjësit shofer
 - Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
 - Leje drejtimi (e vlefshme)

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik, duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme:

- 1 (nje) autobot uji me kapacitet jo më të vogël se 7000-8000 litra
- 1 (nje) pompe me presion/ tub uji te lidhur me cisterne/ makine per trotuare apo kende te veshtira
- 2 (dy) mjete teknologjike transportuese te mbetjeve urbane, me kapacitet minimal 5 ton, të mbyllur, të pajisur me mekanizem ngritës fundor, me ndriçim fundor dhe sinjalizues zanor

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesin dokumentet e mëposhtme provuese:

Për Mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqese dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.8 Operatori ekonomik, duhet të disponojë:

- 1 (një) peshore e kolauduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjise me kapacitet jo me pak se 3 t.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesin dokumentet e mëposhtme provuese:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.9 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve per pastrimin e segmenteve rrugore dhe prerjen e barishteve, nga punonjës të

